



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 141, Datë 24.09.2019

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SH.A., NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5 pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 dhe 37 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.09.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 89/8 Prot, datë 12.09.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi licencimin e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 514 Prot, datë 15.08.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 130, datë 29.08.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 32/37 Prot, datë 30.08.2019, si dhe me shkresën nr. 515/2 Prot, datë 02.09.2019, ERE i’u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 515/3 Prot, datë 03.09.2019, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., ka qënë mbajtëse e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 241, seria T14, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, Nr. 79, datë 09.09.2014, për një periudhë 5 vjeçare, periudhë e cila ka përfunduar në datën 09.09.2019.
- Lidhur me kërkesën e depozituar në ERE nga shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., për të vepruar me procedurë të përshpejtuar, për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, u

krye vlerësimi i provave dhe sqarimeve përkatëse dhe u gjykua se argumentat e dhëna nga kjo shoqëri nuk justifikojnë kërkesën për licencimin me procedurë të përshpejtuar, duke qënë se shoqëria kishte dijeninë në lidhje me detyrimin për të aplikuar për rinovimin e licencës në afatet e parashikuara në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*. Spjegimet e aplikuesit në lidhje me efektet dhe impaktin që ka për shoqërinë pushimi i së drejtës së ushtrimit të aktivitetit të tregtimit për aplikuesin, në kushtet e përfundimit të afatit të licencës së tregtimit r. 241, seria T14, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, Nr. 79, datë 09.09.2014, nuk përbëjnë provë të mjaftueshme për të çuar bordin e ERE në një vendimarrje me procedurë të përshpejtuar.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* të miratuar me vendimin e bordit të ERE- s, nr. 109, datë 29.06.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “AYEN AS ENERGGJI” sh.a., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “AYEN AS ENERGGJI” sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* si më poshtë:
 - Formatimi dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar pjesërisht. Shoqëria me shkresën nr. 515/3, datë 03.09.2019 ka depozituar në ERE Vërtetimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me nr. 2186 Prot., datë 29.08.2019, nga i cili rezulton se për periudhën deri në datën e lëshimit të këtij vërtetimi nuk ka detyrim tatimor për Tatimin mbi fitimin, Tatimin e mbajtur në Burim, Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të ardhurave të punësimit, por shoqëria ka detyrim në TVSH në vlerën 88,773 LEKË për të cilat është në procedurë apelimi për detyrimin e TVSH-së ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë. Aplikuesi ka detyrimin që të njoftojë ERE-n për përfundimin e procedurës së apelit për detyrimin e TVSH-së, ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rrëzojë kërkesën për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të aplikimit të shoqërisë “AYEN AS ENERGGJI” sh.a., nr. 093 Prot, datë 22.08.2019, të protokolluar në ERE me nr. 514/2 Prot, datë 22.08.2019, për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Të licencojë shoqërinë “AYEN AS ENERGJI” sh.a., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar, me kusht që të depozitojë në ERE vërtetimin për përfundimin e procedurës së apelimit për detyrimin e TVSH-së, ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

